



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 12.09.2018

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (GIZ), PËR PROJEKTIN “KËSHILLIMI PËR MIGRACIONIN NË SHQIPËRI”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”*.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Dajna Sorensen dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar synon ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “*Këshillimi për migracionin në Shqipëri*”. Ky projekt ka si objektiv forcimin e kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve kuadër, për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet të luftohet migracioni i parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri. Bashkëpunimi do të fokusohet në:

- fushat e këshillimit për migracionin dhe informimin e grupeve të caktuara mbi mundësitë e migracionit të ligjshëm të punës dhe perspektivat e arsimimit dhe të punësimit në Shqipëri;
- përditësimin dhe ofrimin e materialeve informative rreth migracionit të punës, mundësitë për hyrje në tregun gjerman të punës dhe trajnimet përkatëse për personelin e sporteve të migracionit;
- ngritjen e kapaciteteve të sporteve ekzistuese të migracionit të Shërbimit kombëtar të Punësimit, lidhur me informimin mbi rrugët ligjore të migracionit të punës;
- përmirësimin e bazës të të dhënave për aktorët në terren dhe situatën e grupeve të synuara si dhe krijimin e një rrjeti me aktorët përkatës në fushën e arsimit dhe punësimit.

Kjo marrëveshje ka si bazë marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 21 tetor 1988 për bashkëpunim teknik dhe marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për punësimin e punëtorëve për zgjerimin e njohurive të tyre profesionale dhe gjuhësore, nënshkruar më 10.12.1991.

Objektiv kryesor i programit global, “Migracioni për zhvillim” parashikohet të realizohet në këto fusha veprimtarie:

- Këshillimi për migracionin;
- Këshillimi për politikën e migracionit;
- Kthimi i imigrantëve të orientuar nga zhvillimi;
- Bashkëpunimi me diasporën;
- Ide biznesi për zhvillim.

Objektivat e sipërpërmendur janë pjesë e programit global, “Migracioni për zhvillim”, të autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, të cilat, që prej 23 dhjetorit 2015 janë autorizuar të të zhvillohen edhe në Republikën e Shqipërisë.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i ofrojë GIZ-it deri në 1 500 000 euro për kontributin gjerman. Kjo shumë do të përfshijë edhe shpenzimet e bëra nga Organizata Zbatuese Gjermane. Kontributi është i ndarë në 4 nënkomponentë: si më poshtë:

- Sigurimi i ekspertëve;
- Furnizimi me materiale dhe pajisje;
- Kostot operative dhe administrative;
- Kontribute të tjera.

Kontributi i palës shqiptare do të fokusohet në këto nënkomponentë:

- Sigurimi i 10 ekspertëve, që do të nënkontraktohen nga GIZ dhe përfshirja e 4 personave (personelit ndihmës), për zbatimin e projektit (duke përfshirë institucionet e varësisë);
- Kostot (ku përfshihen pagesa e TVSH-së për aktivitetet e projektit dhe shpenzimet që kryhen në vendin tonë);
- Sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe i ambienteve të punë;
- Kontribute të tjera, ku parashikohet që MFE-ja të mbështesë bashkëpunimin me njësi të tjera kombëtare dhe rajonale të kësaj ministrie në zbatimin e projektit, si dhe me njësi të tjera.

Organi përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri do të jëtë Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Efekte financiare të kësaj marrëveshjeje janë llogaritur në masën e 45 000 eurove për vitin 2019 dhe 45 000 eurove për vitin 2020, në zërin “Kosto lokale e TVSH-së”, të cilat janë planifikuar në projektbuxhetin afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.85, datë 14.2.2018, është nënshkruar nga palët dhe po paraqitet për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë bazuar në parashikimet e ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

1. Gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshjeje, nga anëtarët e komisioni u kërkua informacion më i detajuar lidhur me ndarjen e fondeve të këtij projektit bazuar në objektivat që synohen të realizohen nëpërmjet kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për financat sqaruan se programi synon të fokusohet në objektivat e mëposhtëm:

- Këshillimi për Migrimin në Gjermani për të përgatitur kthimin:* që synon të ofrojë shërbime informacioni dhe këshillimi për njerëzit nga vendet e përzgjedhura të origjinës, që janë të interesuar të kthehen, si dhe forcimi i sistemit të këshillimit të aktorëve të përzgjedhur në Gjermani, që këshillojnë refugjatët dhe ata që duan të kthehen dhe orientimi i sistemit të këshillimit ndaj vendeve të origjinës dhe grupeve të synuar.
- Informacion dhe këshillim në vendet e origjinës:* veçanërisht në formën e qendrave të këshillimit të migracionit, forcimin e strukturave lokale (duke përfshirë kurset e trajnimit) të ndarë si vijon:

- i. 20% Informimi dhe këshillimi direkt dhe virtual (nëpërmjet e-mali/telefon dhe rrjete sociale) i të interesuarve;
 - ii. 20%: Organizimi i aktiviteteve informuese, si Panairë karriere dhe pune, workshope për përgatitjen e CV;
 - iii. 20%: Këshillim referues drejt kurseve të trajnimit profesional dhe mundësive të punësimit tek ofruesit publik, privatë dhe OJF-të.
 - iv. 40%: Mbështetja e zyrave të punës, ngritja e kapaciteteve, trajnimi për këshillimin psiko-social, trajnim për informacionet në lidhje me riintegrimin në Shqipëri të të kthyerve.
- c. *Komponenti i shoqërisë civile:* Në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), Programi Global “Migracioni për zhvillim” promovon projekte nga organizatat e shoqërisë civile, që ofrojnë mbështetje shtesë dhe plotësuese për masat e sektorit publik, duke krijuar mundësi për të kthyerit në vendet e tyre të origjinës.

2. Një çështje tjetër e diskutuar gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshje në komision lidhet me faktin nëse kjo marrëveshje ka në fokus të saj informimin dhe ndërgjegjësimin për programet e arsimit dhe formimit profesional që ofrohen në vendin tonë. Propozuesit sqaruan anëtarët e komisionit, se për shkak të ofertës për arsim profesional që ofrohet në tregun e punës shqiptar, por edhe të programeve të tjera të ofruara në kuadrin e Arsimit dhe Formimit Profesional nga GIZ por edhe nga donatorë të tjerë, ashtu edhe për shkak të kualifikimit të ulët të të interesuarve informimi dhe ndërgjegjësimi për Arsimin dhe Formimin Profesional, si dhe për hapjen e bizneseve të reja, përbën fokusin kryesor të ofertës informuese.

3. Për sa i takon pyetjes së ngritur, lidhur me qasjen që parashikohet të këtë programi, për riintegrimin e emigrantëve të kthyer, përfaqësuesit e ministrisë së financave dhe ekonomisë, sqaruan anëtarët e komisionit se emigrantët e kthyer, informohen dhe orientohen në lidhje me shërbimet që ofrohen dhe procedurat që ata duhet të ndjekin për ri-integrimin në jetën shoqërore dhe në tregun e punës nëpërmjet këtyre formave:

- i. Informimit në qendrat komunitare multifunkionale të shërbimeve sociale të ngritura në disa qytete (si në Shkodër, Korçë, Lezhë dhe Fier) ku ofrohen shërbime të specializuara për menaxhimin e rasteve të familjeve të kthyer.
- ii. Mundësi mbështetje të një vetpunësimi të thjeshtë, për familjet në nevojë,
- iii. Asistencë me këshillim psiko-social dhe me regjistrimin në shkollë.
- iv. Mbështetje e panairëve rajonale të punës, që synojnë referimin e të rinjve shqiptar drejt mundësive për praktikë dhe formim profesional pranë bizneseve shqiptare.

4. Në vijim të kërkesës së anëtarëve të komisionit lidhur me numrin e shtetasve shqiptarë të kthyer dhe të regjistruar në programet e nxitjes së punësimit, përfaqësuesit e ministrisë së financave dhe ekonomisë informuan se gjatë vitit 2017 janë regjistruar pranë Zyrave të Punësimit 530 emigrantë të kthyer, të cilëve u janë ofruar shërbime punësimi, informacion mbi tregun e punës, intervistim, këshillim. Ndësa për periudhën Janar-Korrik 2018 rezultojnë të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit 536 emigrantë të kthyer, si punëkërkues të papunë.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

EDMOND LEKA

ULSI MANJA